



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.975/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.P.P “B...” Sh.P.K me seli në Hani i Elezit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.K avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga e paditura, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1223/17, të datës 06.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.03.2023, merr:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditësit “B...” Sh.P.K me seli Hani i Elezit, e datës 07.10.2020, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1223/2017, i datës 06.10.2020, **Vërtetohet.**

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me aktgjykimin e ankimuar, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit “N.P.P “B...” Sh.P.K me seli në Hani i Elezit, ndërsa ka lënë në fuqi vendimin nr.08/Nr.5233/17 të datës 20.06.2017, i Komunës së Hanit të Elezit.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij, ka ushtruar ankesë, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që aktgjykimi i shkallës së parë të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim ose aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet, padia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurës me nr.08/Nr.5233/2017 i datës 20.06.2017 duke u liruar paditësi nga pagesa e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2015 në shumë prej 1,500.00€.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 22.12.2020 i propozon gjykatës që të nxjerr vendim me të cilin e vërteton Aktgjykimin e gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1223/17 dhe njëkohësisht e refuzon ankesën e paditësit të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194,i Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK),ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

Ankesa është **e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se organi i paditur, me vendimin nr.08/Nr.5233/2017 të datës 20.06.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e Komunës së Hanit të Elezit – Drejtorisë për zhvillim ekonomik 08-nr.5021/98-2015 me të cilin vendim paditësi është ngarkuar me pagesën e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2015, në shumë prej 1,500.00€.

I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi, me padi inicion konflikt administrativ në procedurë gjyqësore. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, në këtë çështje juridike administrative të paditësit, mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 06.10.2020, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur dhe pas administrimit të provave, bjer aktgjykimin e ankimuar me të cilin, e refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe lë në fuqi vendimin nr.08/Nr.5233/2017 i datës 20.06.2017, i Komunës së Hanit të Elezit. Në arsyetim ndër të tjera është theksuar se gjykata konstaton se leja e punës e përcaktuar sipas nenit 38.3 të Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme e cila më pastaj është shfuqizuar me nenin 5 të Ligjit nr.04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2004/18, kishte të bënte me kushtet minimale teknike dhe kushtet e përgjithshme shëndetësore dhe sanitare, të cilat duhet t'i përmbushte lokali afarist ku ushtrohet veprimtaria tregtare sipas nenit 38.1 të ligjit, mirëpo kjo leje e punës nuk ka të bëjë me taksën vjetore të caktuar nga komuna, ne emër të ushtrimit të lejes së aktivitetit afarist sipas Ligjit nr.03/L-040 për Financat e Pushtetit Lokal dhe Rregullores për Pagesën e Taksa, Tarifa dhe Ngarkesave Administrative të Komunës së Hanit të Elezit nr.02/1265 të datës 26.03.2015. Gjykata thekson se në nenin 10 Taksa për lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste të Ligjit nr.03/L-049 për financat e Pushtetit lokal, respektivisht paragrafi 10.1 dhe 10.2 shprehimisht është parashikuar se *“Përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të kërkoj nga shoqëritë tregtare (bizneset) të cilat tashmë janë të regjistruara në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës që të marrin leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste në lokalet të cilat ndodhen brenda komunës (“leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste”). Lejet për shoqëritë tregtare të cilat ofrojnë shërbime profesionale nga lokalet të cilat ndodhen brenda komunës rregullohen në bazë të nenit 11 të këtij ligji dhe jo në bazë të këtij neni. 10.2 përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të përcaktoj një taksë vjetore e cila duhet të paguhet nga shoqëritë e regjistruara tregtare për marrjen ose mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Të gjitha taksat për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste duhet të caktohen vetëm në bazë të rregullave të përcaktuara në rregulloren komunale. Skema tarifore dhe*

*rregullat nuk duhet të përcaktojnë taksa të ndryshme për shoqëri tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme afariste.”* Duke pasur parasysh këto dispozita ligjore e paditura ka nxjerr Rregulloren për Pagesën e Taksave, Tarifave dhe Ngarkesave Administrative të Komunës së Hanit të Elezit nr.02/1265 të datës 26.03.2015, ku ndër të tjera në nenin 15 paragrafi 2, ka përcaktuar taksën vjetore për ushtrim të veprimtarisë së biznesit për gurëthyesit, siç është rasti me paditësin, në shumë vjetore prej 1,500.00€. Prandaj në kuptim të drejtë të këtyre dispozitave ligjore, gjykata arrin në përfundim se e paditura ka vepruar drejtë kur e ka ngarkuar paditësin me pagesën e taksës vjetore në shumë prej 1,000.00€ në emër të dhënies së lejes për zhvillimin e aktivitetit afarist për vitin 2015.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe nenit 81 par.1 të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se padia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale pasi që as vet e paditura nuk është thirrur në dispozitat ligjore në të cilat është thirrur gjykata e shkallës së parë. Pastaj vazhdon se vendimi i të paditurës është tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjin për Tregtinë e Brendshme, ngase me Ligjin nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme i cili është miratuar me datë 16.06.2004, përkatësisht me nenin 38 paragrafi 3 ka qenë e rregulluar që leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste merret nga organi kompetent komunal. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerëson se janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara, meqë paditësi me asnjë provë nuk i ka provuar të njëjtat, andaj si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë për faktin së në baze të nenit 10, Taksa për Lejen për Ushtrimin e Veprimtarisë Afariste, të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, respektivisht neni 10.1 dhe 10.2 shprehimisht është parashikuar se *“Përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të kërkojë nga shoqëritë tregtare (bizneset) të cilat tashmë janë të regjistruara në regjistrin e bizneseve të Kosovës që marrin leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste në lokalet të cilat ndodhen brenda Komunës (leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste). Lejet për shoqëritë tregtare të cilat ofrojnë shërbime profesionale dhe lokalet të cilat ndodhen*

*Brenda komunës rregullohen në bazë të nenit 11 të këtij ligji dhe jo në bazë të këtij neni 10.2. përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të përcaktoj një taksë vjetore e cila duhet të paguhet nga shoqëritë e regjistruara tregtare për marrjen ose mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Rregullorja e sipërpërmendur mund të vendos një skemë tarifore e cila përcakton taksa të ndryshme për kategoritë e ndryshme të veprimtarive afariste. Të gjitha taksat për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste duhet të caktohen vetëm në bazë të rregullave të përcaktuara në rregulloren komunale. Skemat tarifore dhe rregullat nuk duhet të përcaktojnë taksa të ndryshme për shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme afariste”.* Ndërsa e paditura duke zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore ka nxjerr Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe ngarkesa Administrative nr.02/1265 të datës 26.03.2015, ku ndër të tjera në nenin 15 paragrafi 2, ka përcaktuar taksën vjetore për ushtrim të veprimtarisë së biznesit për gurëthyesit, siç është rasti me paditësin, në shumë vjetore prej 1,500.00€

Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa ne arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale, është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera te paditësit, nuk ka mund te konstatohet një gjendje tjetër faktike, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.975/22, me datë 06.03.2023

**Kryetar i Kolegjit,**  
Ramush Bardiqi